



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-10452 dt. 19. 03 2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së dytë të rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 28.02.2025, e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 26 anëtarë.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani (PDK), Labinot Halilaj (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri - Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Kosovare Halilaj-Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Egzon Qorri (LDK), Mergim Pirraku (DD).

Munguan: Egzona Terrdevci (VV), Qendrim Mulaj (PDK), Muhamet Kurtaj (VV), Florentina Elezi-Veliu (VV), Selman Qallapeku (VV).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Arben Shala nënkryetar i Komunës së Drenasit dhe drejtorë të drejtorive.
Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i dt. 31.01.2025;
2. Raporti i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit për vitin 2024;
3. Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
4. Raporti vjetor i punës së njësisë dhe auditimit të brendshëm të Komunës së Drenasit si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2024;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, me një minutë heshtje e filloi mbledhjen në nderim të të rënëve për liri në Likoshan dhe Qirez.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi prezantoi rendin e ditës fjalën ja dha Kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nëse me lejohet dhe jeni të pajtimit, auditori i brendshëm Kamer Rama tha se kanë harruar me dërguar Raportin e brendshëm të auditimit. Ai raport nuk votohet nëse e shihni të arsyeshme e sjellim edhe e vendosim si pikë të rendit të ditës nëse jo e lajm për mbledhjen tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës me pikën shtesë dhe rendi i ditës kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit më 31.01.2025. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës dhe kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 2. Raporti i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit për vitin 2024.

Kryetarja e Komisionit Valentina Leku tha se, ne si komision pas një periudhe të gjatë po raportojmë në pika të shkurta për punën tonë afërsisht dy vite, jemi duke shqyrtuar secilën kërkesë veç e veç duke u bazuar në Ligjin nr.04/L-071, për sistemin e adresave dhe Udhëzimin Administrativ për emërtimin e listës rezervë dhe vendosjes së tyre në regjistrin Komunal të adresave. Ne jemi duke punuar edhe në shkresën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me rastin e emërimit dhe riemërimit të rrugëve ku duhet të kenë parasysh kriteret të cilat janë të përcaktuara në paragrafin 1.3 të nenit të Udhëzimit Administrativ 17/2019 për krijimin alfabetike për emërimin e listës rezervë dhe vendosjes së tyre në regjistrin Komunal të adresave, në bashkëpunim me Agjensionin Kadastral të Kosovës. Fillimisht ne jemi duke bërë listën rezervë dhe duhet aprovimi nga AKK-ja dhe t'i sjellim në Kuvend, ne e kemi bërë një listë por për shake që duhet me u koordinuar me AKK-në, me qenë se është në proces dhe nuk e kemi përfunduar akoma kemi vendosur ta sjellim muajin e ardhshëm.

Mehdin Salihu, pyeti unë kam njoftime se ka mjaft ankesa dhe a keni mundur me i shqyrtuar këto ankesa a nuk i keni shqyrtuar ende.

Valentina Leku tha se, ne kemi dal në terën në disa rajone, por kemi një numër të madh të kërkesave dhe ankesave. Ne kemi zgjedhur një rajon dhe kemi marr kërkesat e të

gjitha viteve p.sh nëse kemi zgjedhur Çikatovën, të gjitha kërkesat prej vitit 2020 e deri me tani i kemi grumbulluar dhe kemi me dal në terën, por është një numër shumë i madh dhe jemi në proces duke punuar.

Beqir Kiqina, pyeti se kur do të merret epilogu dhe sa parashihen që kërkesat me u trajtuar dhe me marrë një përgjigje të caktuar, faleminderit.

Valentina Leku, tha se ne nuk mundemi me dhënë një afat të caktuar, është një komision jashtëzakonisht shumë sfidues dhe e dini se cili prej jush kemi probleme dhe sfida për me dalë në terën dhe e kemi problem me e mbledh komisionin për shkak të angazhimeve të tjera, ne jemi duke u munduar me dhënë maksimumin.

Mërgim Pirraku, kërkoi nga komisioni me e zgjidh këtë problem sa më shpejt që është e mundur dhe ju kisha lutur të kuptohet se emërim i rrugëve është diçka shumë i rëndësishëm ajo mundë të jetë sot një rrugicë nesër mundë me qenë një rrugë tepër e rëndësishme. Unë e kam vërejtur në terren se ka pasur rrugë që janë emërtuar pa kurrfarë kriteri, unë kam respekt për çdo njeri, por kanë emërtuar rrugë ndoshta në emër të babagjyshit të vet, kështu që ju kisha lutur t'i emërtoni me të gjitha kriteret, faleminderit.

Valentina Leku, Mërgim kjo është njëra prej sfidave, ne pavarësisht se kush donë me emëruar me emrin e gjyshit, ne nuk mundemi me ja ndaluar, njerëzit bëjnë kërkesa si të duan mirëpo sigurisht që ne kemi kriteret.

Beqir Kiqina, duke e parë gatishmërinë e punës së juaj dhe ju përgëzoj për angazhimin se kam qenë në kontakt të vazhdueshëm. Ne e dimë që është një komision i cili me të vërtet donë një tretman të veçantë duke shikuar se sa kanë ankesa dhe kërkesa për emra të rrugëve. A ka mundësi me shkuar gradualisht disa kërkesa të cilat nuk kanë ankesa dhe me u trajtuar me biseduar edhe me kompani përkatëse disa prej tyre me filluar me marr epilog, me u emëruar rrugët që mos me i lënë të gjitha për një herë në momentet e fundit në përfundim të mandatit, por me shkuar me disa që janë të zgjedhura dhe me ju dhënë hapësirë vetëm rasteve të cilat janë në kontest me i trajtuar dhe nëse ka nevojë për ndihmë shtesë edhe prej anëtarëve të tjerë të Kuvendit, sepse është një komision që me të vërtet donë një trajtim të veçantë.

Problemi është të rrugët aktuale që janë të emëruara në kontest, të cilat janë të emëruara dy herë, një herë në fillim dhe njëherë në përfundim të rrugës, segmentet e caktuara që nuk janë të caktuara si duhet kështu që ato që i keni shikuar në terren me filluar me procedura në vazhdim.

Valentina Leku, tha se unë vazhdimisht kam kërkuar ndihmë prej juve dhe prej ekzekutivit, kam kërkuar edhe informacion, falënderoj secilin që nuk ka hezituat më na dhënë informacione që ne me punuar sa me mirë në këtë drejtim. Në raportin që kemi me e sjell janë ato kërkesa që nuk kanë probleme, janë të përfunduara disa regjione që kemi dalë në tërën.

Labinot Halilaj, a e keni marr ndonjë raport prej komisionit paraprak, a është trajtuar edhe ai material.

Valentina Leku, tha se ne e kemi shikuar raportin e komisionit të kaluar dhe i kemi shikuar krejt rrugët që i kanë lënë në rezervë edhe ato të aprovuarat ky është informacioni i im që nëse ne i dërgojmë rrugët sikur pako të votohen edhe nisë njëra prej tyre nuk i ka plotësuar kushtet për me u emëruar, atëherë kthehet si pako kundër dhe bie krejt në pikën zero.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, ky është komisioni më i vështirë që e kryen detyrën dhe që nuk kanë mundur me përfunduar edhe në mandatin e kaluar edhe në këtë mandat. Më herët i kanë bërë emërimet dhe riemërimet mbi ato rrugë pa përfunduar asnjë procedurë, prandaj është mirë edhe nëse zgjatët, se krejt këto ankesa në fund të fundin bien mbi mua. Kjo është detyrë e Kuvendit me i zgjidhë problemet e rrugëve, rrugicave, shesheve, ju e dini që plotë rrugë kanë pasur emra në votimin e parë të Kuvendit në Drenas, kanë pasur emra të tjerë sot kanë emra tjerë, një rrugë që fillon e mbaron nuk mundet me i pasur tre emra, siç i ka rruga Drenas – Komoran.

Besoi që komisioni kur të përfundon punën është mirë me i pasur parasysh këto probleme, me i zgjidhe një herë e përgjithmonë, ndryshimi i emrit të një rrugë nuk mund të bëhet brenda 10 viteve, është rregullore me ligj dhe mundet me na refuzuar MPL-ja. Sipas rregullores një herë emërohen me emra të dëshmorëve pastaj luftëtarëve të luftës së fundit, mandej me ata të luftërave të më hershme edhe të ndonjë babagjyshi që ka dhënë ndonjë kontribut, por çdo emër që vendosët duhet me e bërë një kërkesë, një shkresë, një histori të personit në fjalë, unë e falënderoj komisionin për punën që kanë bërë, sepse kanë një punë të vështirë edhe që nuk paguhet.

Kamer Rama, tha se sipas kërkesave të pyetësorit dhe vlerësimit të performancës së komunave, është një raport përmbledhës vjetor i aktiviteteve themelore të njësisë së auditimit të brendshëm që përfshin Planin strategjik gjatë vitit 2024 të auditimit të brendshëm. Me plane të punës i kishim paraparë që të kryheshin shtatë auditime në fusha të cilat janë me rrezikshmëri me të lartë. Të gjitha këto auditime janë kryer dhe janë përmbyllur me një raport të shkruar për menaxhmentin, gjithashtu kemi kryer edhe dy auditime për vlerësimin dhe zbatimin e rekomandimeve tona të dhëna me herët. Këto raporte çdo here janë dorëzuar në Komitetin e auditimit të brendshëm i cili ka shqyrtuara dhe aprovuar këto dhe ka nxjerr konkluzione për menaxhmentin, këto raporte kanë përfunduar gjithsej.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, vazhdojmë me piken e tretë 3. Propozim- vendimi për plotësim-ndryshim të Vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e tretë, me vota unanime kaloi edhe pika e tretë e rëndit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4. Raporti vjetor i punës së njësisë së auditimit të brendshëm të Komunës së Drenasit si dhe Plani i veprimtimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2024.

Auditor Kamer Rama, përshëndetje për të gjithë, Raporti përmbledhës vjetor mbi aktivitet themelore të njësisë së auditimit të brendshëm ku përfshin Planin strategjik të njësisë së auditimit të brendshëm, Planin vjetor për vitin 2024, auditimin e përfunduar raportimin para komitetit të auditimit dhe para njësisë qendrore harmonizuese kujdesit për zbatimin e rekomandimeve dhe raportimin e shkallës së zbatimit të rekomandimeve si dhe aktivitete që i ka ndërmarr menaxhmenti në lidhje me adresimin e këtyre rekomandimeve gjatë vitit 2024.

Njësia e auditimit të brendshëm i kishte paraparë me plan të punës që të kryheshin shtatë auditime në fushat të cilat janë me rrezikshmëri më të lart, të gjitha këto auditime janë përmbyllur me një raport të shkruar për menaxhmentin, gjithashtu i kemi përfunduar edhe dy auditime për vlerësim dhe zbatim të rekomandimeve tona të dhëna më herët. Këto raporte çdo herë janë dorëzuar në komitetin e auditimit të brendshëm i cili i ka shqyrtuar dhe ka aprovuar dhe i ka nxjerr konkluzionet për menaxhmentin. Raportet e auditimit gjatë vitit 2024 kanë përfunduar me 58 rekomandime për përmirësim të sistemeve ku 26 prej tyre janë të zbatuara në tersi, 27 janë në proces të zbatimit dhe 5 prej tyre në fund të vitit 2024 nuk kishte filluar ende adresimi i tyre. Gjatë verifikimit të rekomandimeve kemi verifikuar se menaxhmenti nuk kishte një afat për zbatimin e tyre, menaxhmenti ka ndërmarr 61 aktivitete për implementimin e këtyre rekomandimeve në këtë e falënderojmë menaxhmentin për angazhimet që i ka bërë dhe për aktivitetet që i ka ndërmarr për zbatimin e rekomandimeve tona.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, unë dëshiroj me këtë rast të falënderoj zyrën e auditimit të brendshëm për punën që e ka bërë dhe për vërejtjet këshillat dhe kritikën që ka dhënë, po ashtu i falënderoj edhe të gjithë zyrtaret që i kanë harmonizuar dhe i kanë plotësuar të gjitha rekomandimet që i ka dhënë auditori i brendshëm.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 5. Të ndryshme. Pasi nuk pati vërejtje, diskutime mbledhja përfundoi.

Më gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit, të dt. 28.02.2025 mund ta ndiqni në ueb faqen zyrtare të Komunës, në rrjetin social. <https://youtu.be/dS-uJiuEGdE>.

Mbledhja përfundoi në ora 11:35.

Procesmbajtësja



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Bekim Lestrani